

## Vendim nr. 183 datë 18.09.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, në datën 18.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** DAVID GJOKEJA, përfaqësuar nga avokat Alfred Duka.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 207, datë 14.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 352, datë 25.09.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2012-1457 (268), datë 17.10.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi David Gjokeja (*kërkuesi*), bashkë me dy vëllezërit e tij A.Gj. dhe K.Gj., janë proceduar penalisht dhe në vijim janë akuzuar dhe dërguar për gjykim për veprat penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, të kryer në bashkëpunim, kundër dy ose më shumë personave dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “dh”, 25 dhe

278, paragrafi 2, të Kodit Penal (KP), në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 18.06.2005, ku si pasojë e një sulmi me armë zjarri ka mbetur i plagosur shtetasi S.Gj., ndërsa kanë gjetur vdekjen djali dhe nipi i tij i mitur, shtetasit E.Gj. dhe O.Gj. Gjatë hetimeve paraprake ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit personal “Arresti në burg”, por ajo nuk është zbatuar ndërsa ai ka qenë i larguar jashtë shtetit.

2. Gjykimi fillestar i çështjes është zhvilluar në mungesë të kërkuesit dhe ai është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur nga familjarët. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 565, datë 08.11.2006, ndër të tjera, ka vendosur deklarin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 25 të KP-së, duke e dënuar me burgim të përjetshëm, sikundër e ka deklaruar atë fajtor edhe për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 2, i KP-së, duke e dënuar me 6 vjet burgim, ndërkohë që në bashkim të dënimeve ka caktuar ndaj tij një dënim të vetëm, atë me burgim të përjetshëm. Pas ankimit edhe nga avokati i kërkuesit, ky vendim është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim në shkallë të parë nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 170, datë 25.04.2007.

3. Edhe rigjykimi i çështjes është zhvilluar në mungesë të kërkuesit, duke u mbrojtur ai përsëri nga avokati i zgjedhur nga familjarët. Në përfundim të rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 207, datë 14.04.2009, ndër të tjera, ka vendosur sërish deklarin fajtor të kërkuesit për veprat penale për të cilat akuzohej, duke caktuar përfundimisht ndaj tij një dënim të vetëm, atë me burgim të përjetshëm. Pas ankimit të këtij vendimi edhe nga mbrojtësi i kërkuesit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 352, datë 25.09.2009, ndër të tjera, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me kërkuesin. Po kështu, pas rekursit të paraqitur edhe nga mbrojtësi i kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1457(268), datë 17.10.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

4. Vendimi i dënimit penal të kërkuesit ka mbetur i pazbatuar deri në datën 19.03.2016, kur ai është ndaluar nga policia duke hyrë në territorin shqiptar në pikën e kalimit kufitar të aeroportit të Rinasit, ndërsa në vijim ai është burgosur në zbatim të vendimit të dënimit penal.

5. Në datën 21.04.2016 kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit nr. 207, datë 14.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kjo e fundit, me vendimin nr. 178, datë 17.05.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 148, datë 12.10.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së

shkallës së parë, ndërsa për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-875, datë 09.11.2017, ka vendosur mospranimin e tij.

6. Ndërsa çështja e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të dënimit penal ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve nr. 207, datë 14.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 352, datë 25.09.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2012-1457 (268), datë 17.10.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të dhëna në përfundim të procesit gjyqësor për gjykimin e themelit të çështjes penale. Në lidhje me këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 78, datë 12.04.2017 (*vendimi nr. 78/2017*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare duke mbajtur qëndrimin se, në kushtet kur kërkesa për rivendosje në afat ishte ende në proces në Gjykatën e Lartë, nuk ishin shteruar mjetet juridike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi përpara se kërkuari t'i drejtohej me kërkesë kësaj Gjykate.

7. Po kështu, në datat 07.08.2017 dhe 28.08.2017, kërkuari i është drejtuar edhe gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 207, datë 14.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kërkesat janë bashkuar në një gjykim të vetëm dhe në përfundim të tij Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2017-6489) 442, datë 20.12.2007, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim. Pas ankimit të kërkuarit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2018-680 (113), datë 29.03.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa për rekursin e kërkuarit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2191, datë 19.12.2023, ka vendosur mospranimin e tij.

8. Në datën 10.05.2024 (*data e shërbimit postar*), kërkuari, nëpërmjet mbrojtësit të tij, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të sipërcituar. Kërkesa, pasi është plotësuar me dokumentacionin e kërkuar, është regjistruar përfundimisht në datën 27.05.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 24.07.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

9. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

9.1. Gjatë procesit gjyqësor i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës për t'u mbrojtur nga mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe për t'u dëgjuar*, pasi proceset gjyqësore penale për gjykimin e themelit janë

zhvilluar në mungesë të tij duke mos pasur mundësi për të paraqitur parashtrimet e tij për të kundërshtuar akuzat dhe i është hequr e drejta e ankimit ndaj vendimit të tij.

9.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata brenda një periudhe të shkurtër kohore ka marrë vendime që bien ndesh me jurisprudencën e saj. Kërkuesi i është drejtuar edhe më parë Gjykatës me kërkesë për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore penale (procesi i themelit), por Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin nr. 78/2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike. Por në një rast tjetër, Gjykata, me vendimin nr. 31/2015, pavarësisht se situatat ishin të njëjta ka mbajtur qëndrim të ndryshëm. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka miratuar rezolutën për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit, të cilat si akte ndërkombëtare kanë fuqi detyruese, pasi prevalojnë ndaj Kushtetutës duke bërë të domosdoshme të gjenden mjetet juridike efektive që personi i gjykuar në mungesë të ketë mundësi për t'u dëgjuar përpara gjykatës, si dhe të mbajë qëndrim ndaj vendimit të dhënë kundër tij.

9.2. Argumentimi i gjykatave të zakonshme për mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë se gjykimi në mungesë sipas nenit 352 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, është i ndryshëm nga gjykimi në mungesë sipas nenit 352 përpara ndryshimeve, ngushton hapësirën e të drejtave të personave të gjykuar në mungesë, në kundërshtim me urdhërimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin

e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

11. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka parashtruar pretendimet për: i) për procesin e themelit të përfunduar me vendimin nr. 00-2012-1457 (268), datë 17.10.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; ii) shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të paraqitur në vitin 2017; iii) zbatimin e nenit 352 të KPP-së lidhur me mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për të gjykuarin në mungesë.

12. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimin të këtyre kritereve, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor penal dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ai nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

15. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijëni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes është i datës 17.10.2012.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 10.05.2024 (data e shërbimit postar), pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2191, datë 19.12.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës për çështjen me objekt rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 207, datë 14.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili është bërë i disponueshëm për palët në datën 12.02.2024, sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Lartë.

17. Në vlerësimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, paraqitja e një kërkesë për rishikim, që nuk pranohet nga gjykata, nuk përcakton ditën se kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar është bërë përfundimtar, me qëllim përlllogaritjen e afatit ligjor 4–muor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Mbledhja e Gjyqtarëve mban në konsideratë faktin se kërkesa për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, kur nuk pranohet nga gjykata, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të një procesi gjyqësor.

18. Për më tepër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në paraqitjen e ankimit kushtetues individual me objekt kundërshtimin e procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë individët nuk mund të pretendojnë të parashtrojnë pretendime që lidhen me procesin gjyqësor për themelin e çështjes duke përdorur afatin ligjor 4-mujor të procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor, si mjet i jashtëzakonshëm ankimit, i cili është refuzuar nga gjykata si i pabazuar në ligj.

19. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se për kërkimin thelbësor të parashtruar nga kërkuesi, si në objektin e kërkesës dhe në përmbajtjen e saj, për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore penale për shqyrtimin e themelit të çështjes, ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000. Gjithashtu, referuar rrethanave të çështjes, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se pas vendimit nr. 00-2017-875, datë 09.11.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka shqyrtuar kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit, kërkuesi nuk i është drejtuar Gjykatës, duke mos shfrytëzuar mundësinë dhe përmbushjen e detyrimit sipas vendimit nr. 78/2017 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

20. Në lidhje me kërkimin e dytë, për pretendimet për vendimin nr. 78/2017 të marrë në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës, Mbledhja e Gjyqtarëve rithekson se vendimet e Kolegjeve të Gjykatës dhe të Mbledhjes së Gjyqtarëve, të dhëna në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesës, nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë Gjykatës (*shih vendimet nr. 30, datë 18.04.2024; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*), për rrjedhje pretendimi i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

21. Për kërkimin e tretë, për mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesi ka parashtruar se vendimi është marrë në zbatim të gabuar të nenit 352 të KPP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, pasi kjo dispozitë ka ngushtuar hapësirën e të drejtave të personave të gjykuar në mungesë, në kundërshtim me urdhërimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, që dallon nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 24, datë 09.04.2024; nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më sipër, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesi, në mbështetje të pretendimeve të tij për cenimin e procesit të rregullt ligjor, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të interpretimit e zbatimit të ligjit dhe, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, por në atë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

23. Si përfundim, bazuar në arsyetimin e mësipërm, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, shkronjat “a”, “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.